



Data	17.01.2025
Numri	
Për	Drejtorin e DSHMS-së, Dr. Kemajl Emini
Nga	Drejtoresha e QKMF-së, Dr. Nadire Ymeri
Lënda	Plani i punës në QKMF për vitin 2025

PLANI I PUNËS NË QKMF PËR VITIN 2025

Personeli i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare e filloi vitin 2025 me angazhimet e nevojshme me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe detyrave të punës. Që në ditët e para të **vitit 2025**, puna filloi me ritmin e zakonshëm nëpër të gjitha QMF – të dhe AMF-Mirash, për të vazhduar më tej me synim të aktivizimit edhe të AMF-ve tjera. Si gjithmonë, përkushtimi ndaj organizimit të punës, sigurimi i ligjshmërisë në punë ,afarizmi ,puna profesionale në QKMF dhe eliminimi i ngecjeve eventuale, kanë qenë preokupim i vazhdueshëm i stafit menaxhues dhe hap imediat drejt përmbushjes së objektivave të paracaktuara për vitin 2025 të cilat janë:

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore.
2. Plotësimi i nevojave për personel shëndetësor përmes blerjes së shërbimeve profesionale, nëpërmjet kontratës (Marrëveshjes) mes Komunës së Ferizajt dhe ndonjë OE.
3. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe performancës në punë në KPSH.
4. Monitorimi i vazhdueshëm i standardeve bazike në KPSH.
5. Koordinimi i punëve në Edukimin dhe Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional.
6. Kujdesi për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien në punë të të gjithë të punësuarve.
7. Angazhimi i vazhdueshëm në plotësimin e standardeve teknike dhe ngritja e performancës në punë në AMF të komunës sonë.
8. Përmirësimi i infrastrukturës me ndërtimin e objekteve QKMF, QMF 2 dhe QMF në fshatin Koshare.
9. Funkcionalizimi i laboratorëve në QMF-6 në fshatin Pleshinë, në QMF-8 në fshatin Neredime dhe në QMF-Prelez të Muhaxherëve.
10. Shtimi i analizave të reja në laboratorin e QKMF-së: T3. T4 dhe TSH, analizën e hemoglobinës së glikozuar dhe CRP-në

11. Avancimi i punës ekipore.
12. Zbatimi i buxhetit të QKMF-së nën mbikqyrje dhe autorizim nga DSHM-së
13. Zonimi dhe listimi e pacientëve për mjek.
14. Krijimi i një plan-strategjie për shtimin e numrit të specializantëve të rinj në Mjekësi Familjare.
15. Vazhdimi i implementimit të tërësishëm të SISH-it , programit të SMSF-së të vaksinimit dhe Sistemit SMSN/Moduli TB..
16. Mundësimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe trajnimi i personelit të QKMF-së sipas planit nacional të ZHVP-së.
17. Fuqizimi i aktiviteteve të Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor, me shtimin e kapaciteteve humane dhe në bashkëkoordinim me kordinatoren për EPSH.
18. Fuqizimi i Programit të Vizitave Shtëpiake për Nëna dhe Fëmijë nga 0-3 vjeç, me shtimin e kapaciteteve humane dhe në bashkëkoordinim me kordinatoren e këtij programi.
19. Fuqizimi i Vizitave Shtëpiake Paliative.
20. Renovimi i objekteve shëndetësore.
21. Furnizimi me pajisje të reja mjekësore, stomatologjike dhe laboratorike.
22. Bashkëpunimi me Këshillin e Pacientëve, pjesëmarrja e tyre në mbledhje të KD siç e parasheh Statutit Unik i QKMF-së..
23. Bashkëpunimi me OJQ-të dhe identifikimi i donatorëve .
24. Vazhdimi i botimit të numrave të tjerë të revistës Kujdesi Shëndetësor , etj.

Me respekt,



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE
FERIZAJ